



C.nr.185/13

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Ardian Ajvazi, në çështjen juridike kontestimore të iniciuar me padinë e paditëses Këshilli për Menagjimin e Objekteve të ish Bankës së Kosovës në Ferizaj dhe Kaçanik (Bankos), të cilën e përfaqëson Arben Hasi Zyrtar i Agjencisë Kosovare të Privatizimit, kundër të paditurit [REDACTED] nga fshati [REDACTED] Komuna e [REDACTED] baza e kontestit përbushja e kontratës, në seancën publike të mbajtur me datës 30.05.2016, merr këtë:

A K T G J Y K I M

-NË BAZË TË POHIMIT-

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses Këshilli për Menagjimin e Objekteve të ish Bankës së Kosovës në Ferizaj dhe Kaçanik (Bankos), e ushtruar kundër të paditurit [REDACTED] nga fshati [REDACTED], Komuna e [REDACTED] për shkak të përpushjes së kontratës.

II. DETYROHET i padituri [REDACTED] nga fshati [REDACTED], Komuna e [REDACTED], që paditëses Këshilli për Menagjimin e Objekteve të ish Bankës së Kosovës në Ferizaj dhe Kaçanik (Bankos), në emër të përbushjes së kontratës t'ia paguaj shumën prej 4,900.00 Euro (katër, nëntë, zero, zero), në llogarinë bankare me numër 1000501000075072 në Bankën Qëndrore të Kosovës (BQK), në afat prej 15 ditësh pas pranimit të këtij Aktgjykimi e nën kërcënimin e përbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m i

Paditësja, në këtë gjyaktë ka ushtruar padi me datë 18.03.2013, kundër të paditurit, për përbushjen e kontratës.

Gjykata ka caktar seancën për shqyrtimin kryesor me datë 30.05.2016, në të cilën kanë qenë prezent përfaqësuesi i AKP-së Arben Hasi dhe i padituri [REDACTED]. Në po këtë seancë i padituri e pohojë në tërësi kërkesëpadinë e paditëses dhe i propozojë Gjykatës të aprovonë në tërësi si të bazuar. Deklarata e shprehur e palës së paditur (expressis verbis) është veprim procedural dhe i njëanshëm dhe pas vlerësimit nga ana e Gjykatës se një pohim i tillë është në përputhje më ligj dhe palët ndërgjygjëse mund të disponojnë me këto kërkesa merrë këtë Aktgjykim në bazë të pohimit dhe e aprovonë në tërësi kërkesëpadinë e paditëses.



Nuk mund të ketë aktgjykim në bazë të pohimit në rastet kur palët nuk mund të disponojnë lirisht me objektin e kontestit dhe se kur disponimet e palëve ndërgjygjëse janë në kundërshtim me dispozitat e detyrueshme, në rastin konkret Gjykata ka vlerësuar se palët ndërgjygjëse disponojnë me të drejtat objekt kontesti dhe janë në përputhje me dispozitën e nenit 148 të LPK-së. Meqenëse i padituri i pohojë faktet e çështjes në tërësi, Gjykata nuk lëshohet në vërtetimin e gjendjes faktike.

Baza Ligjore

Në nenin 148 të Ligjit për Procedurën Kontestimore parashihet paragrafët: 1 “*Në qoftë se i padituri deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor të çështjes e pohon kërkesëpadinë pjesërisht apo tërësisht, gjykata e jep, pa shqyrtim të mëtejmë, aktgjykimin me të cilin e aprovon pjesën apo gjithë kërkesëpadinë (aktgjykimi në bazë të pohimit)”; 2 “*Gjykata nuk e jep aktgjykimin në bazë të pohimit, edhe pse janë plotësuar kushtet e nevojshme, po që se konstaton se është fjala për kërkesën me të cilën palët nuk mund të disponojnë lirisht (paragrafi 3 i nenit 3 të këtij ligji)”; 3 “*Dhënia e aktgjykimit në bazë të pohimit mund të shtyhet për më vonë në qoftë se është e nevojshme që për rrethanat nga paragrafi 2 i këtij neni të merren njostimet e duhura”; 4 “*Deklaratën mbi pohimin e kërkesëpadisë i padituri mund ta revokojë verbalisht në seancë gjyqësore, apo me anë të parashtresës jashtë seancës gjyqësore, edhe pa pëlqimin e paditësit, deri në momentin e dhënies së aktgjykimit*”.***

Andaj nga të theksuarat më lartë, e duke u bazuar në nenin 148 të LPK-së ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

C.nr.185/13, me datë 30.05.2016

Gjyqtari,

Ardian Ajvazi



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, e të dorëzohet përmes kësaj Gjykate. Afati fillon nga dita e nesërme nga pranimit i këtij Aktgjykimi.

REPUBLICA E KOSOVËS  REPUBLICA K.

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUKA JE PRVNOSNAZNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ / UROSEVAC

